



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI NR: 1

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

NR I VENDIMIT: KPCC/D/A/148/2012
DATA E VENDIMIT: 19/04/2012

ORDER

- (1) Në secilën prej 29 (njëzet e nëntë) kërkesave të identifikuar në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që paraqitësi i kërkesës ka vërtetuar pronësinë e paraqitësit të kërkesës ose mbajtësit të së drejtës pronësore sipas rastit, për pronat e kërkuara.;
- (2) Në secilën prej 29 (njëzet e nëntë) kërkesave të referuara në paragrafin (1) më sipër, Komisioni,
- Urdhëron që
- (a) Paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, sipas rastit, t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar;
 - (b) Çdo person i cili ka uzurpuar pronën në mënyrë të paligjshme, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri; dhe
 - (c) Nëse çdo person që ka uzurpuar pronën, i cili dështon të përmbushë urdhrin për lirim të pronës brenda kohës së dhënë, të dëbohet nga prona;
- (3) Në secilën kërkesë të përmendur në kolonat përkatëse në pjesët A dhe B të listës së bashkëngjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të hidhen poshtë kur paraqitësit e kërkesave kërkojnë kompensim për dëmin material apo për humbjen e shfrytëzimit të pronës së; dhe
- (4) Në rastet kur ka më shumë se një pronar vendimet dhe urdhrat e mësipërm nuk ndikojnë në të drejtat e bashkëpronarëve repsektive.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksit e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksit e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të

5. Komisioni mbajti seancën e njëzet e tetë nga 17 deri 19 prill 2012 në Prishtinë. Komisionit i janë paraqitur gjithsej 2135 kërkesa për pronë bujqësore në seancën e njëzetë e tetë, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së (“Sekretaria Ekzekutive”), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante. Tri kërkesa për pronë bujqësore të cilat iu paraqitën Komisionit u tërhoqën gjatë seancës nga Sekretaria Ekzekutive. Komisioni ndërpreu shqyrtimin e gjashtë kërkesave për pronë bujqësore në pritje të mbajtjes të seancës dëgjimore. Përveç kësaj, Komisioni vendosi 25 kërkesa të cilat ishin pezulluar më parë në pritje të mbajtjes së seancës dëgjimore. Gjithsej 2,151 kërkesa për pronë bujqësore u vendosën nga Komisioni gjatë seancës.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesa të përfshira në këtë vendim.

7. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës pronësore. Të gjitha kërkesat kanë të bëjnë me pronat bujqësore, përfshirë arat, kullotat dhe pyjet.

8. Ky vendim zbatohet për 29 kërkesa të identifikuara në listën e bashkangjitur. Kërkesat nr. 23499, 26057, 35613, 35614 dhe 42173 kanë qenë subjekt i nje vendimi të mëparshëm të Komisionit.² Megjithatë vendimi i mëparshëm për këto kërkesa është shfuqizuar për shkak të notifikimit të pasaktë të pronave të kërkuara gjatë përpunimit të kërkesave nga Sekretaria Ekzekutive të cilat janë identifikuar pas marrjes së vendimit. Për rrjedhojë, këto kërkesa duhet të rivendosen pas notifikimit të saktë të pronave të kërkuara. Sekretaria Ekzekutive u ka shkruar paraqitësve të kërkesave duke i informuar ata për gabimin e notifikimit dhe se kërkesat do të rivendosen pas notifikimit të saktë të pronave të kërkuara. Paraqitësit e kërkesave si dhe autoritetet përkatës kadastrale janë informuar se vendimet e mëparshme të Komisionin janë të pavlefshme dhe se ato nuk mund të shfrytëzohen për qëllimet e transaksionit ligjor. Pjesa e mbetur prej 2,122 kërkesash për prone bujqësore përfshihen në vendimet KPCC/D/A/147/2012 dhe KPCC/D/A/149/2012.

9. Të gjitha 29 kërkesat e përfshira në këtë vendim janë kontestuese në kuptimin se pala apo palët që kanë uzurpuar pronat e kërkuara ose pala që ka shprehur interes ligjor në pronat e tilla (“pala përgjegjëse”) e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda 30 ditësh të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme të procedurës në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut /2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079.

10. Me qëllim që të përmbushen kushtet e një kërkesë të vlefshme, paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të tregojë se ai ka pasur të drejtë pronësore në lidhje me pronën e kërkuar dhe se ai ose ajo nuk ka mundësi të ushtrojë të drejtën

tri Anekset e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislativë dhe Komisioni do t’u referohet në këtë vendim si Nën-Anekset I, II dhe III, respektivisht.

² Kërkesa nr. 35613 është vendosur me vendimin KPCC/D/A/19/2008 datë 20 qershor 2008, Kërkesa nr. 35614 dhe 42173 me vendimin KPCC/D/A/8/2008 datë 22 shkurt 2008 dhe kërkesat nr. 23499 dhe 26057 me vendimin KPCC/D/A/13/2008 datë 30 prill 2008.

pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë ose rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

1. Kërkesa kontestuese – mbrojtje e thjeshtë.

11. Në gjashtë kërkesat e identifikuara në pjesën A të listës së bashkangjitur, pala që ka uzurpuar pronën e kërkuar ose pala që ka shprehur interes ligjor në pronën e tillë (“pala përgjegjëse”) ose nuk ka paraqitur mbrojtje ligjërsh të vlefshme ose thjesht ka deklaruar se ka pasur lejen e paraqitësit të kërkesës për të shfrytëzuar pronën pa ofruar ndonjë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij. Në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga ana e palëve përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesat duhet të miratohen.

a. Kërkesa nr. 10326

12. Në kërkesën nr. 10326, paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Fillimisht prona e kërkuar u notifikua pasaktësisht dhe u konstatua e uzurpuar nga pala përgjegjëse i cili e kundërshtoi kërkesën bazuar në notifikimin e pasaktë. Pala përgjegjëse nuk e ka tërhequr kundërshtimin pas notifikimit të dytë, të saktë të pronës së kërkuar.

b. Kërkesa nr. 11021

13. Në kërkesën nr. 11021, paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese e cila tregon pronën e kërkuar në emrin e tij. Fleta poseduese është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si e vërtetë. Fillimisht, prona e kërkuar është notifikuar pasaktësisht dhe u konstatua e uzurpuar nga pala përgjegjëse, i cili e kundërshtoi kërkesën bazuar në notifikimin e pasaktë. Pala përgjegjëse pretendon se e ka këmbyer pronën e kërkuar më paraqitësin e kërkesës rreth 30 vjet më parë, megjithatë ai dështoi të paraqitë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij. Pala përgjegjëse nuk e ka tërhequr kundërshtimin e tij pas notifikimit të dytë e të saktë të pronës së kërkuar.

c. Kërkesat nr. 13267 dhe 13268

14. Në kërkesat nr. 13267 dhe 13268, paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëshortit të tij. Pala përgjegjëse pohoi se ai i bleu pronat e kërkuara nga bashkëshorti i paraqitësit të kërkesës por dëshmitë e paraqitura nga pala përgjegjëse nuk kanë të bëjnë me parcelën e kërkuar. Gjatë verifikimit të dokumenteve, Sekretaria Ekzekutive konstatoi se pronat e kërkuara ishin shënuar gabimisht në emër të palës përgjegjëse dhe në emër të bashkëpronarëve të tjerë, megjithatë ato ishin shitur tek pala përgjegjëse. Kontrata e blerjes e paraqitur nga pala përgjegjëse nuk ka të bëjë me pronat e kërkuara por me parcela të ndryshme që janë kërkuar në kërkesën nr. 13269. Zyra Komunale Kadastrale në Ferizaj bëri korrigjimet dhe pronat e kërkuara u rikthyen në emër të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëshortit të paraqitësit të kërkesës.

d. Kërkesat nr. 35613 dhe 35614

15. Në kërkesat nr. 35613 dhe 35614, paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij të ndjerë. Pala përgjegjëse pohoi se ai ka lejen nga paraqitësi i kërkesës për të shfrytëzuar pronën e kërkuar. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, paraqitësi i kërkesës deklaroi se në të vërtetë ai i kishte dhënë lejë të përkohshme palës përgjegjëse për të

shfrytëzuar pronën e kërkuar por marrëveshja me gojë është ndërprerë dhe pala përgjegjëse nuk ka më lejë për të shfrytëzuar pronën.

e. Kërkesa nr. 56712

16. Kërkesa nr. 56712 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese në emër të tij dhe një bashkëpronari tjetër. Fleta poseduese është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si e vërtetë. Gjatë notifikimit të pronës së kërkuar, pala përgjegjëse e kundërshtoi kërkesën por dështoi të paraqitë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij.

2. Kërkesa kontestuese –të tjera.

17. Në 23 kërkesat e identifikuar në pjesën B të listës së bashkangjitur, pala apo palët që kanë uzurpuar pronat e kërkuara ose pala që ka shprehur interes ligjor në pronat e tilla (“pala përgjegjëse”), ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës, megjithatë, Komisioni ka arritur në konkluzion se kërkesat duhet të miratohen për arsyet e përcaktuara më sipër.

a. Kërkesa nr. 00312

18. Në kërkesën nr. 00312, paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës paraqiti vendimin e trashëgimisë dhe procesverbalin e gjykatës për ndarjen e pronës së kërkuar. Dokumentet janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si të vërteta. Gjatë notifikimit të pronës së kërkuar, pala përgjegjëse e kundërshtoi kërkesën duke pretenduar se ai e kishte shfrytëzuar pronën nga viti 1990 deri 1999 me lejen e mbajtësit të së drejtës pronësore dhe kishte paguar qira nga ana e tij. Pala përgjegjëse pretendon se para konfliktit kishte lidhur parakontratë me paraqitësin e kërkesës për blerjen e pronës së kërkuar dhe se i kishte paguar një shumë paraqitësit të kërkesës por se marrëveshja përfundimtare nuk ishte bere për shkak të konfliktit. Me tej, ai pranon se ka vazhduar të shfrytëzojë pronën pas konfliktit pa pëlqimin e paraqitësit të kërkesës. Pala përgjegjëse pohon se prona e kërkuar ka qenë e familjes së tij deri në vitin 1945, kur ajo u shpronësua. Megjithatë, pala përgjegjëse dështoi të ofrojë dëshmi në mbështetje të pohimeve të tij.

b. Kërkesat nr. 22219 dhe 22220

19. Në kërkesat nr. 22219 dhe 22220, kërkesat janë depozituar nga përfaqësuesi i autorizuar i paraqitësit të kërkesës i cili i kërkon pronat në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese në emrin e tij dhe vendimin e trashëgimisë i cili tregon se ai ka trashëguar pronat e kërkuara nga babai i tij. Të dy dokumentet janë verifikuar si të vërteta nga Sekretaria Ekzekutive. Pala përgjegjëse pohon se i ka blerë pronat e kërkuara në vitin 2001 nga mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore. Megjithatë, pala përgjegjëse dështoi të ofrojë dëshmi për të mbështetur transaksionin e pretenduar.

c. Kërkesa nr. 23499

20. Në kërkesën nr. 23499, paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese në emër të tij e cila është verifikuar si e vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive. Gjatë notifikimit të pronës së kërkuar, pala përgjegjëse e kundërshtoi kërkesën por nuk e dëshmoi kundërshtimin dhe as nuk ofroi dëshmi të mbështetje të tij.

d. *Kërkesat nr. 28524 dhe 92486.*

21. Në kërkesën nr. 28524, paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të ndjerë të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Kërkesa nr. 9248 është bërë nga një paraqitës tjetër i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht gjyshit të tij. Të dyja kërkesat lidhen me të njëjtën pronë dhe se paraqitësi i parë i kërkesës është xhaxhain/daja i paraqitësit të dytë të kërkesës. Fleta poseduese u gjet *ex officio* nga Sekretaria Ekzekutive dhe është në emër të mbajtësit të ndjerë të së drejtës pronësore dhe vëllait të tij. Pala përgjegjëse, i cili po e shfrytëzon pronën e kërkuar e kundërshtoi kërkesën duke pretenduar se e kishte blerë pronën e kërkuar nga djemtë e mbajtësit të së drejtës pronësore, megjithatë ai nuk ofroi dëshmi në mbështetje të pohimeve të tij. Paraqitësit e kërkesës e mohojnë që prona e kërkuar të jetë shitur.

e. *Kërkesa nr. 26057*

22. Në kërkesën nr. 26057, paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të ndjerë të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëshortit të saj. Pala përgjegjëse pretendon se e ka kultivuar parcelën që nga viti 1990 me pëlqimin e mbajtësit të së drejtës pronësore. Sekretaria Ekzekutive u përpoq të kontaktonte paraqitësin e kërkesës, por arriti të kontaktojë vetëm vajzën e paraqitësit të kërkesës e cila deklaroi se mbajtësi i së drejtës pronësore, pikërisht babai i saj, nuk i kishte dhënë leje askujt për të shfrytëzuar pronën e kërkuar. Paraqitësi i kërkesës paraqiti gjithashtu vendimin e trashëgimisë që e deklaronte atë si trashëgimtare të mbajtësit të ndjerë të së drejtës pronësore, megjithatë, Komisioni vëren se vendimi nuk është nxjerrë nga gjykata kompetente. Rrjedhimisht kërkesa duhet të miratohet në emër të mbajtësit të dëshmuar të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëshortit të ndjerë të paraqitëses së kërkesës.

f. *Kërkesat nr. 35690 dhe 35691*

23. Në kërkesat nr. 35690 dhe 35691, paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij të ndjerë. Pala përgjegjëse pretendon se ai po shfrytëzon pronën e kërkuar me lejen e paraqitësit të kërkesës. Kur u kontaktua me pas nga Sekretaria Ekzekutive, pala përgjegjëse deklaroi gjithashtu se ai kishte blerë një pjesë të parcelës të kërkuar në kërkesën nr. 35690 nga babai i paraqitësit të kërkesës. Megjithatë, pala përgjegjëse dështoi të ofrojë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij. Bashkëshortja e paraqitësit të kërkesës deklaroi se bashkëshorti i saj nuk i kishte dhënë leje askujt të shfrytëzojë pronat dhe ajo e mohoi shitjen e ndonjë pjese të pronave të kërkuara.

g. *Kërkesa nr. 36998*

24. Në kërkesën nr. 36998, paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij të ndjerë. Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme që e tregon pronën e kërkuar në emër të babait të paraqitësit të kërkesës. Gjatë notifikimit të pronës së kërkuar, pala përgjegjëse e kundërshtoi kërkesën duke pohuar se e kishte blerë pronën nga babai i paraqitësit të kërkesës dhe xhaxhai i paraqitësit të kërkesës dhe si dëshmi paraqiti një kontratë informale të blerjes të lidhur në vitin 2000. Pala përgjegjëse pretendon se e ka pasur të pamundur të vërtetojë kontratën në gjykatë pasi paraqitësi i kërkesës banon në Serbi. Megjithatë, Komisioni vëren se numri i parcelës së pronës së kërkuar nuk është i shënuar në kontratën e blerjes. Paraqitësi i kërkesës konfirmon se prona të tjera të babait të tij i ishin shitur palës përgjegjëse por jo prona e kërkuar.

h. Kërkesa nr. 41350

25. Në kërkesën nr. 41350 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht nënës së tij të ndjerë. Paraqitësi i kërkesës paraqiti një fletë poseduese që e tregon pronën e kërkuar në emër të nënës së tij. Fleta poseduese është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si e vërtetë.

26. Fillimisht pala përgjegjëse pretendoi se ai dhe vëllai i tij e kishin blerë pronën e kërkuar se bashku me prona të tjera në pronësi të nënës së paraqitësit të kërkesës, nga nena e paraqitësit të kërkesës në vitin 1986, dhe se ai i ka shfrytëzuar ato vazhdimisht që nga ajo kohë. Pala përgjegjëse pohon se nuk kanë lidhur kontratë më shkrim midis palëve, por se ai i ka paguar çmimin, për të cilin janë pajtuar, nënës së paraqitës të kërkesës përmes llogarisë bankare. Më tej, pala përgjegjëse tregoi dëshmitarët të cilët mund të konfirmojnë shitjen e pretenduar. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës e mohoi se nëna e tij i kishte shitur pronën e kërkuar palës përgjegjëse.

27. Gjatë seancës së 27 më 29 shkurt 2012 Komisioni urdhëroi që të mbahet seance dëgjimore për këtë rast nga një nga anëtarët e tij në bazë të nenit 5.4 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Të dy palët dhe dëshmitarët e palës përgjegjëse u ftuan për seancën dëgjimore më 29 mars 2012 në ndërtesën e AKP-së në Prishtinë. Pala përgjegjëse, përfaqësuesi i tij i autorizuar Nexhat Beqiri dhe dy dëshmitarët e emëruar nga pala përgjegjëse, Sheremet Curri dhe Imer Mustafa, morën pjesë në seancë dëgjimore. Pala përgjegjëse deklaroi se ai dhe vëllai i tij Hamdi Makiqi e kishin blerë pronat e kërkuara nga nëna e paraqitësit të kërkesës Darinka Radec, në vitin 1985 me çmimin e blerjes prej 150 milion dinarësh. Me tej ai pohoi se kanë pasur posedimin e pronave të kërkuara qysh atëherë dhe e kanë kultivuar tokën. Pala përgjegjëse pretendoi se ai dhe vëllai i tij kishin paguar çmimin e blerjes në dy këste; pagesa fillestare prej 20 milion dinarësh ishte bërë personalisht shitësit Darinka Radec, dhe pjesa e mbetur i ishte paguar djalit të saj Momcilo përmes llogarisë bankare në Jugobanka. Megjithatë, pala përgjegjëse sqaroi se pylli i cili është subjekt i kësaj kërkesë nuk ka qenë pjesë e transaksionit të pronës midis palës përgjegjëse dhe vëllait të tij dhe nënës së paraqitësit të kërkesës. Në të vërtetë, transaksioni ka të bëjë më prona të tjera të cilat kërkohej nga paraqitësi i kërkesës përmes kërkesave të tjera para Komisionit; këto kërkesa janë vendosur me vendim të Komisionit KPCC/D/A/156/2012.

28. Më 3 prill 2012, u mbajt seanca dëgjimore për paraqitësin e kërkesës në ndërtesën e AKP-së në Mitrovicë, pasi ai nuk kishte pasur mundësi të merrte pjesë në seance dëgjimore në Prishtinë. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se është pronar i parcelës së kërkuar, pyll në fshatin Resnik e dëshmuar kjo me fletën poseduese. Ai pretendoi gjithashtu se pylli ishte prerë pas vitit 1999 nga persona të paautorizuar, megjithatë ai deklaroi se nuk ua ka shitur pronën e kërkuar askujt.

29. Bazuar në dëshmitë para tij, përfshirë dëshmitë e ofruara në seance dëgjimore, Komisioni konstaton se nena e paraqitësit të kërkesës është mbajtësja e së drejtës pronësore dhe se prona e kërkuar nuk është shitur. Kështu, kërkesa nr. 41350 duhet të miratohet në emër të nënës së ndjerë të paraqitësit të kërkesës si mbajtëse e së drejtës pronësore.

i. Kërkesat nr. 42173 dhe 42175

30. Në kërkesat nr. 42173 dhe 42175, paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij të ndjerë. Sa i takon kërkesës nr. 42173, paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese në emër të mbajtësit të së drejtës pronësore; dokumenti është verifikuar si i vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive. Pala përgjegjëse e kundërshtoi kërkesën duke pohuar se babai i tij e kishte blerë pronën në vitin 1977 nga një person i tretë. Megjithatë, pala përgjegjëse nuk paraqiti ndonjë dokument në mbështetje të pretendimeve të tij. Paraqitësi i kërkesës mohoi të ketë pasur shitje dhe deklaroi se prona e kërkuar i takon babait të tij.

31. Në lidhje me kërkesën nr. 42175, paraqitësi i kërkesës pretendon se babai i tij i ndjerë, në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore, e shkëmbeu parcelën 581/2 me parcelën e palës përgjegjëse 1045/1 para konfliktit të vitit 1999. Sipas paraqitësit të kërkesës shkëmbimi është bërë në bazë të kontratës së shkëmbimit, megjithatë ky transaksion nuk është reflektuar ende në regjistrat kadastralë. Deklarata e paraqitësit të kërkesës u konfirmua nga pala përgjegjëse Ibrahim Jasharaj, i cili konfirmoi se parcela në fjalë është shkëmbyer në vitin 1981. Pala përgjegjëse pretendon gjithashtu se ai i ka paguar një shumë shtesë të hollash babait të paraqitësit të kërkesës pasi prona e shkëmbyer vlente më shumë se prona e tij. Sipas palës përgjegjëse, kontrata e shkëmbimit është djegur gjatë konfliktit.

32. Duke marrë në konsideratë faktin se të dy palët e kërkesës nr. 42175 janë dakord se ka pasur shkëmbim të pronave, Komisioni konsideron se kërkesa e paraqitësit të kërkesës duhet të miratohet në emër të babait të ndjerë për parcelën e shkëmbyer 1045/1, por jo për parcelën e kërkuar fillimisht.

j. Kërkesat nr. 47401, 47402, 47405 dhe 47408

33. Në kërkesat nr. 47401, 47402, 47405 dhe 47408, paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht stërgjyshit të tij. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese në emër të stërgjyshit të tij. Ky dokument është verifikuar si i vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive.

34. Pala përgjegjëse në kërkesat nr. 47401 dhe 47402, i cili aktualisht po shfrytëzon pronën, pohon se i ka blerë pronat e kërkuara shumë kohë më parë, megjithatë dokumentet e kontratës janë djegur gjatë konfliktit. Ai refuzoi të bashkëpunonte më tej me Sekretarinë Ekzekutive.

35. Pala përgjegjëse në kërkesën nr. 47405, i cili aktualisht po shfrytëzon pronën, pohon gjithashtu se e ka blerë pronën e kërkuar nga paraqitësi i kërkesës. Megjithatë, ai refuzoi të bashkëpunonte me Sekretarinë Ekzekutive.

36. Pala përgjegjëse në kërkesën nr. 47408 pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar nga një pale e tretë, jo nga mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore ose familja e tij. Me tej ai pohon se transaksioni është bërë bazuar në një kontratë informale dhe se të gjitha dokumentet që tregojnë shitjen janë shkatërruar gjatë konfliktit.

37. Rrjedhimisht, Komisioni vëren se asnjë nga tri palët përgjegjëse nuk ofroi dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tyre.

k. Kërkesat nr. 10302 dhe 10303

38. Në kërkesat nr. 10302 dhe 10303, paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se ajo është pronarja e vetme e pronës së kërkuar në kërkesën nr. 10302, ndërsa në kërkesën nr. 10303 ajo kërkoi bashkëpronësi. Prona e kërkuar në kërkesën nr. 10302 u konstatua të jetë në emër të bashkëshortit të paraqitësit të kërkesës, megjithatë, bazuar në vendimin e trashëgimisë të lëshuar pas vdekjes së bashkëshortit të saj, paraqitësi i kërkesës trashëgoi pronën e kërkuar. Në bazë të vendimit të trashëgimisë, paraqitësi i kërkesës trashëgoi gjithashtu pjesën ideale prej 1/5 të pronës së kërkuar në kërkesën nr. 10303. Vendimi i trashëgimisë në fjalë është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si i vërtetë.

39. Pala përgjegjëse, i cili aktualisht po shfrytëzon pronën e kërkuar në kërkesën nr. 10302, e kundërshton kërkesën e paraqitësit të kërkesës. Pala përgjegjëse pohon se prona e kërkuar i takon familjes së tij, pasi u është dhënë atyre në vitin 1986 përmes procesit të konsolidimit të tokës. Sipas palës përgjegjëse, ai dhe familja e tij e kanë shfrytëzuar pronën e kërkuar deri në vitin 1995 kur, ashtu si pretendohet, ata janë larguar forcërisht nga policia.

40. Pala përgjegjëse në kërkesën nr. 10303 pohon në mënyrë të ngjashme se prona e kërkuar i ishte dhënë familjes së tij në vitin 1986 përmes procesit të konsolidimit të tokës dhe se ata e kanë shfrytëzuar atë deri në vitin 1995 kur ashtu si pretendohet, policia i largoi ata me force.

41. Sekretaria Ekzekutive u kërkoi të dy palëve përgjegjëse të paraqesin vendimin për konsolidimin e tokës ose ndonjë dokument tjetër i cili do të tregonte të drejtën e tyre pronësore të pretenduar. Të dy palët përgjegjëse u përgjigjen se nuk janë të interesuar të paraqesin dokumentacion në Sekretarinë Ekzekutive dhe deklaruan se janë të interesuar të blejnë pronat respektive. Të dy palët përgjegjëse dështuan të paraqesin dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tyre.

l. Kërkesa nr. 14022

42. Në kërkesën nr. 14022, paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëpronarit të pronës së kërkuar. Paraqitësi i kërkesës paraqiti një vendim trashëgimie dhe një fletë poseduese që e tregon pronën në emrin e saj, të cilat të dyja janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si të vërteta. Gjatë notifikimit, prona e kërkuar u konstatua e uzurpuar nga pala përgjegjëse, i cili e kundërshtoi kërkesën duke pohuar se i takon familjes së tij. Pala përgjegjëse paraqiti dëshmi, megjithatë kjo dëshmi nuk lidhet me parcelën e kërkuar por me një parcelë ngjitur me pronën e kërkuar. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi palën përgjegjëse duke i kërkuar atij të paraqitë dokumentin përkatës por ai dështoi ta bëjë këtë.

43. Paraqitësi i kërkesës i mohoi pretendimet e palës përgjegjëse dhe deklaroi se ajo është bashkëpronare e pronës së kërkuar së bashku me motrat/vëllezërit e saj.

m. Kërkesa nr. 25504

44. Kërkesa nr. 25504, paraqitësi i kërkesës paraqiti kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Gjatë notifikimit, prona e kërkuar u konstatua e uzurpuar nga pala përgjegjëse i cili e kundërshtoi kërkesën dhe paraqiti kontratën e blerjes të vitit 2002 të lidhur midis vëllait të paraqitësit të kërkesës si shitës dhe palës përgjegjëse dhe një pale të tretë si blerës. Sipas kontratës, vëllai i paraqitësit të kërkesës shiti pjesën ideale prej 1/2 tek pala

përgjegjëse. Më pas, parcela e kërkuar u nda në dy nënparcela të reja, dhe paraqitësi i kërkesës në kërkesën nr. 25504 kërkon nënparcelën e tij. Nuk është kontestues fakti se ai është pronar dhe nuk e ka shitur nënparcelën e tij. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, Zyra Komonale Kadastrale përkatëse konfirmoi se për nënparcelën në pronësi të paraqitësit të kërkesës, vëllai i tij ishte shënuar gabimisht si bashkëpronar. Pala përgjegjëse nuk e konteston pronësinë e paraqitësit të kërkesës për nënparcelën.

n. Kërkesa nr. 38251

45. Kërkesa nr. 38251 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Ajo ka paraqitur një vendim trashëgimie të verifikuar bazuar mbi të cilin, ajo dhe vëllai i saj e kanë trashëguar pronën e kërkuar nga babai i tyre.

46. Pala përgjegjëse, i cili po shfrytëzon aktualisht pronën e kërkuar, pretendoi fillimisht se ai e kishte blerë pronën në vitin 1984 dhe ka pasur posedimin e saj të qetë që nga ajo kohë. Më tej, ai pohoi se dokumentet dhe dëshmitë e tjera që do dëshmonin transaksionin ishin shkatërruar gjatë konfliktit. Pala përgjegjëse shpjegoi se nuk ka pasur mundësi ta regjistrojë transaksionin në regjistrat kadastralë për shkak të rrethanave politike. Megjithatë, kur Sekretaria Ekzekutive i kërkoi atij të dëshmojë pretendimet, pala përgjegjëse deklaroi se ai e kishte blerë pronën tashmë 50 vite më pare. Paraqitësi i kërkesës e mohon që prona e kërkuar të jetë shitur.

47. Komisioni vëren se deklaratat e ndryshme të palës përgjegjëse në lidhje me datën dhe rrethanat e transaksionit të pretenduar nuk përputhen dhe për rrjedhojë nuk janë të besueshme. Komisioni arrin në përfundimin se pala përgjegjëse ka dështuar të bëjë një kundërshtim të vlefshëm ndaj kërkesës së paraqitësit të kërkesës.

48. Nga sa u tha më sipër, Komisioni bazuar në dëshmitë që i posedon, konstaton se në kërkesat e identifikuar në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur:

- (a) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, ka të drejtën e pronësisë në lidhje me pronën e kërkuar, apo pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;
- (b) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, në secilin rast, tani nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij apo të saj të pronësisë; dhe
- (c) kërkesa në secilin rast përfshijnë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999

49. Rrjedhimisht, pasi paraqitësit e kërkesave në secilën prej kërkesave të identifikuar në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur, kanë dëshmuar të drejtën pronësore për pronën e kërkuar dhe në mungesë të një mbrojtje të vlefshme nga ana e palës përgjegjëse, të gjitha këto kërkesa duhet të miratohen.

3. *Kërkesat për kompensim*

50. Komisioni vëren se në disa nga kërkesat e përfshira në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave gjithashtu kërkojnë, përveç pronësisë, kompensimin për dëmin material apo humbje të shfrytëzimit, të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesat e tilla. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të hidhen poshtë.

B. Vërejtjet përmbledhëse

51. Vendimet dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

52. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 i miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo është e përshtatshme në rastin konkret.

53. Vendimi i Komisionit nuk cenon të drejtën e paraqitësve të kërkesave ose mbajtësve të së drejtës pronësore, sipas rastit, për të kërkuar konfirmimin e të drejtës pronësore për pronat e kërkuara para autoriteteve kompetente vendore ti tilla si autoritetet kadastrale ose gjykatat vendore, në pajtim me ligjin në fuqi.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze.**

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part A/Pjesa A/Deo A

KPA10326	KPA13267	KPA13268	KPA35614	KPA35613	KPA11021	
----------	----------	----------	----------	----------	----------	--

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part B/Pjesa B/Deo B

KPA26057	KPA35690	KPA35691	KPA38251	KPA56712	KPA36998	KPA47401
KPA47402	KPA47405	KPA47408	KPA10302	KPA10303	KPA14022	KPA22219
KPA22220	KPA23499	KPA25504	KPA28524	KPA92486	KPA00312	KPA42173
KPA42175	KPA41350					